



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:015592

Datë: 28.09.2023

Numri i dokumentit: 04729960

P.nr.609/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit L.Xh. nga F.K., i akuzuar për veprën penale Vjedhje e rëndë neni 327 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2849/18 të datës 28.02.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 18.09.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi dhe të akuzuarit L.Xh., me mbrojtësen e tij sipas detyrës zyrtare av. Shyrete Shalaku Grajçevci, me datë 19.09.2023 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 28.09.2023 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.XH., nga babai N. dhe nëna A., mbiemri i vajzërisë D., i lindur më datë ... në Gj., me vendbanim në F.K., rruga “E.M.”, me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 02.02.2018 rreth orës 04:52, në rrugën “N.T.” në F.K., saktësisht në M.Sh. ‘...’ i pandehurin L.XH. dhe i mituri A.M., me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme për veti apo për tjetrin, me forcë duke e thyer derën e M.Sh. “...” kanë depërtuar brenda dhe kanë vjedhur dy (2) telefona të tipit “Alcatel” në vlerë prej 40 Euro, një (1) Tablet të tipit “Prestige” në vlerë prej 60 Euro, një (1) Laptop të tipit “Toshiba” në vlerë prej 250 Euro, dy (2) telefona të tipit Samsung në vlerë prej 220 Euro, një (1) Tablet të tipit “Samsung” në vlerë prej 150 Euro, një (1) telefon të tipit “Samsung S4” në vlerë prej 70 Euro dhe një (1) telefon të tipit “Samsung S3” në vlerë prej 130 Euro, me ç ‘rast të dëmtuarit V.M. i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale.

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë neni 327 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4 par 1 nen par 1.1, 7, 8, 9, 17 par 1, 21, 41, 42 par 1 nen par 1.1, 43 par 1 nen par 1.2 dhe 1.3, 46 par 1, 2 dhe 3, 73, 74, 75 par 1 nen par 1.2 dhe 1.3 dhe nenit 327 par 1 të KPRK-së dhe neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME BURGIM DHE ME GJOBË

- I.** Në kohëzgjatje *prej tetë (8) muaj burgim*, dhe *me gjobë në shumën prej 300 Euro* (treqind) të cilat dënime do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje t' a paguaj dënimin me gjobë atëherë gjoba do të i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 € (njëzet euro) do të i caktohet një (1) ditë burgim.
- III.** Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- IV.** I dëmtuari Valon Millaku për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në procedurë civile.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.2849/18 të datës 28.02.2020, ndaj të akuzuarit L.XH. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Nazmi Krasniqi, të akuzuarit L.XH. dhe mbrojtësen e tij sipas detyrës zyrtare av. Shyrete Shalaku Grajçevci, ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 të KPRK-së, i ka premtuar Gjykatës që kurrë në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën e tillë, ka deklaruar se që nga mosha gjashtë (6) vjeçare ka pasur probleme familjare duke përfshirë dhunë psikike dhe fizike e të cilat rrethana kanë ndikuar në jetën dhe formimin e tij.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë.

Mbrojtësja i të akuzuarit av. Shyrete Shalaku Grajçevci ka deklaruar se i mbrojturi im pranimin e fajësisë e bën pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtëse e tij, pranimi i fajësisë bëhet në mënyrë vullnetare, i akuzuari që nga atëherë nuk ka kryer veprë tjetër penale, dhe i ka kërkuar Gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë të akuzuarit dhe të merr si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari V.M., përmes deklaratës me shkrim të cilën e ka dorëzuar në Gjykatë me datë 31.08.2023, ka deklaruar, se i akuzuari nuk ka asnjë përgjegjësi ndaj të njejtë dhe se nga ana e të dëmtuarit është i falur në të gjitha rrethanat.

Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarinimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2018- AE-1036, i datës 02.02.2018, raporti i policit B.H. #9831, i datës 02.02.2018, procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarit V.M., i datës 07.02.2018 dhënë në Prokurorin Themelore në Prishtinë, Raporti Zyrtar Policor N.G. #4779, i datës 05.02.2018, Raporti i Policit Hetues E.G. #8332, i datës 04.02.2018, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës së Policisë, i datës 02.02.2018, procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarit L.XH., i datës 05.02.2018, si dhe foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit L.XH. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndëse në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer dhe kërkim faljen e tij. Ndërsa si rrethanë rëndëse ishte fakti se i pandehuri ka kryer këtë veprë penale me dashje si dhe shkallën e dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprës penale

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 42 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Gjykata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoj ne kontest civil për realizimin e kërkesës se saj pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.609/20 më datë 28.09.2023**

Bashkëpunëtori Profesional

Albrim Kastrati

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.